



UNIVERSITETI
BARLETI

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

UNIVERSITETIT BARLETI

DHE

KNC sh.p.k

TIRANË

ME DATË __/__/2024



UNIVERSITETI BARLETI

KNC sh.p.k përfaqësuar nga z. Denald Saliu , funksioni Administrator, është institucion privat, veprimtaria e të cilit bazohet në ligjet në fuqi të Shtetit Shqiptar.

Adresa; Rruga Ismail Qemali , Tiranë, Albania

Dhe

UNIVERSITETI BARLETI përfaqësuar nga Prof. Assoc, Dr. Mateo Spaho, funksioni Dekan i Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes, dhe Drejtësisë, përgjegjës i Departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes, dhe Financës, është institucion privat (universitet), veprimtaria e të cilit bazohet në Ligjin nr.8788

Adresa: Universiteti Barleti | Rr. Frang Bardhi, Selitë | 1001, Tiranë

MEQËNËSE

A. KNC shpk ka si objekt të veprimtarisë “Ndertime te objekteve shumekateshe, rruges, tunelesh, urash, vepra ujore, hekurudhore, kanalizime, impiante etj”

B. UNIVERSITETI BARLETI

Universiteti Barleti është institucion jopublik i arsimit të lartë krijuar në vitin 2005 mbi bazën e VKM nr. 571, dt. 12.08.2005 “Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare private Marin Barleti”, me dy fakultete dhe pesë programe studimi.

Universiteti Barleti është i pari institucion i arsimit të lartë në Shqipëri që u ngrit nën drejtimin e kualifikuar të një Bordi Akademik.

Që nga koha e hapjes së tij, Universiteti Barleti, punon për të krijuar një profil të qëndrueshëm, dinamik me programe cilësore, bashkëkohore që gërshetojnë akademinë dhe kërkimin shkencor sipas kërkesave gjithmonë në rritje dhe ndryshim të tregut të punës dhe sfidave të zhvillimit.

Që në gjenezën e tij, Universiteti Barleti ka zhvilluar në rritje një ofertë akademike ndërdisiplinore në fushat më të spikatura nga kërkesa e tregut, shoqërisë, politikës, ambientit. Diplomat e tij mbulojnë sektorë si: biznes, teknologji informacioni, drejtësi, mësuesi në sporte, dizajn, shkenca sociale, arkitekturë, urbanistikë, etj., dhe krijojnë mundësi jo vetëm për programe akademike të të tre niveleve por dhe për formim profesional nëpërmjet programeve të veçanta. Në rrugëtimin e tij, institucioni ka mundësuar jo vetëm studimet profesionale dhe të aplikuara universitare, e pasuniversitare, por dhe shërbime të tjera si ato të testimit dhe programeve të trajnimit të vazhdueshëm



UNIVERSITETI BARLETI

profesional dhe licencimit, nëpërmjet bashkëpunimeve të shumëllojshme me organizma profesionale, shoqata dhe punëdhënës.

C. Ekziston një vullnet i lirë i palëve që të bashkëpunojnë në arritjen e qëllimeve të përbashkëta për:

- ✓ Shkëmbimin e eksperiencave më qëllim realizimin e praktikës mësimore dhe punësimit të studentëve dhe të të diplomuarve në Universitetin BARLETI.
- ✓ Bashkëpunimin në fushën e asistencave teknike dhe profesionale reciproke duke vënë në dispozicion kapitalin intelektual të palëve.
- ✓ Bashkëpunimin në fushën e iniciativave të përbashkëta për aplikimin në projekte, në programe të edukimit afat shkurtër, konsulencave të specializuara, etj.
- ✓ Aplikimi dhe Implementimi i projekteve dhe programeve të financuara me fondet e EU, apo donatoreve të ndryshëm ndërkombëtar si USAID, ËB, IFC, EBRD, Qeveria Shqiptare, dhe jo vetëm.



PALËT BIEN DAKORD si vijon:

NENI I

OBJEKTIVI

Palët e kësaj marrëveshje Bashkëpunimi, duke vepruar mbi bazën e dispozitave të saj si dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi, do të përpiqen të përforcojnë, promovojnë dhe zhvillojnë bashkëpunimin e tyre reciprok mbi bazën e barazisë dhe përfitimit të përbashkët në çdo fushë të kësaj marrëveshje.

NENI II

FUSHAT E BASHKËPUNIMIT

1. KNC sh.p.k do të angazhojë, sipas një plani të caktuar, student dhe të diplomuar të universitetit në punë promovuese, nëse ekziston gatishmëria dhe dëshira e mirë e personave në fjalë.
2. KNC sh.p.k në kuadër të veprimtarisë së vet, do t'ju mundësojë studentëve te universitetit BARLETI kryerjen e praktikës profesionale të parashikuar në planin mësimor. Dinamika e realizimit të punës praktike do të përcaktohet me dokumentacion të veçantë që specifikon detyrimet e palëve për çdo grup praktike të çdo fakulteti.
3. Ekspertë të KNC sh.p.k do të kenë mundësinë të mbajnë në universitetin BARLETI leksione për promovimin e institucionit të tyre dhe të veprimtarisë së tij.
4. Universiteti BARLETI do të aplikojë tarifa preferenciale për anëtarët e stafit të shoqërisë KNC të cilët do të ndjekin studimet në programet e studimit të universitetit.
5. Palët do të realizojnë veprimtari të përbashkëta kërkimore, promovuese dhe marketing, me qëllim rritjen e cilësisë, imazhit të institucioneve respektive si dhe sensibilizimin e qytetarëve me projektet e përbashkëta të dy institucioneve.
6. Palët do të zhvillojnë forume të përbashkëta, konferenca shkencore, simpoziume, seminare, dhe shumë veprimtari te tjera të këtij lloji me interes reciprok.
7. Palët do të zhvillojnë veprimtari të përbashkëta promovuese dhe marketing, me qëllim sensibilizimin e qytetarëve me projektet e përbashkëta të dy institucioneve.
8. Palët do të shkëmbejnë materiale akademike dhe informacione të tjera duke respektuar parimin e konfidencialitetit dhe mirëbesimit.
9. Universiteti BARLETI do të zhvillojë tarifa preferenciale për të gjitha studimet, konsulencat, këshillimet apo trajnimet që do të realizojë për KNC sh.p.k.



NENI III

KUSHTET E BASHKEPUNIMIT

1. Kjo marrëveshje Bashkëpunimi nuk shoqërohet me detyrime apo ndikim financiar ndërmjet palëve përveç rasteve kur palët bien dakord ndryshe.
2. Kostot dhe shpenzimet që lindin nga kjo marrëveshje do të mbulohen nga secila palë me buxhetin e tyre.
3. Nëse nga bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve bazuar në parimet e mësipërme, lind nevoja për financimin e projekteve të përbashkëta, të dy institucionet do t'i rregullojnë këto raporte me anë të marrëveshjes së veçantë financiare, të cilat do të jenë pjese integrale e kësaj Marrëveshje.
4. Të dy palët, në bazë të mundësive, mjeteve financiare që disponojnë dhe potencialit akademik e profesional, do të aplikojnë në organizma dhe institucione të ndryshme për realizimin e projekteve të përbashkëta.
5. Rezultatet e këtij bashkëpunimi dhe përfitimet reciproke kur ato ekzistojnë bëhen publike vetëm me aprovimin e të palëve. Palët ruajnë konfidencialitetin e informacioneve të përfituara nga njëri-tjetri.
6. Palët bien dakord që të ruajnë dhe të respektojnë integritetin reciprok.

NENI VI

EFEKTET E KESAJ MARREVEESHJE

Kjo marrëveshje mirëkuptimi nuk përbën ose krijon dhe nuk ka për qëllim të përbëjë ose të krijojë detyrime ligjore detyruese ose të zbatueshme, të shprehura ose të nënkuptuara.

NENI V

PERSONAT E KONTAKTIT

Për të zbatuar objektivat e shprehura më sipër palët mirëkuptohen dhe bien dakord në mënyrë reciproke për sa më poshtë:



UNIVERSITETI BARLETI

1. Propozimet për bashkëpunim sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi do të paraqiten përmes personave të kontaktit të caktuar nga secili institucion.
2. Për Universitetin BARLETI person kontakti është dr. Edvin Stefani në cilësinë e lektorit në Departamentin e Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës me email e.stefani@umb.edu.al, 0682050708.
3. Për KNC sh.p.k person kontakti është Znj. Jonida Sota , financiere e-mail: jonidakosho@gmail.com: +355692078200

NENI VI

HYRJA NE FUQI DHE KOHËZGJATJA

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit mes palëve dhe lidhet për një periudhë tre vjeçare, me të drejtë rinovimi pas kërkesës dhe pëlqimit të dy palëve. Kjo kontratë rregullohet, interpretohet dhe zbatohet në përputhje me legjislacionin në fuqi në republikën e Shqipërisë. Ajo mund të ndryshohet në çdo moment nëse palët bien dakord dhe vetëm me anë të një dokumenti të shkruar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Kjo marrëveshje shfuqizon çdo marrëveshje ndërmjet palëve.

Universiteti BARLETI

Prof. Assoc Dr. ~~Mareo Spaho~~

Dekan

KNC sh.p.k

Denald Saliu

Administrator

Denald Saliu

